



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljublanës) Katë V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH.nr 119/23

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105,106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP), në përbërjen Vedat Poterqoi - Kryetar, Kimete Gashi-Referuese, Vjosa Gradinaj Mexhuani-Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik (OE) "Bageri Bujar Shabani B.I.& AVAG Group shpk" me seli në Ferizaj, kundër vendimit për dhënie të kontratës, për aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i rrugëve në lagjet Sllovi, Gadime, Smallushe, Gumnaselle, Llugaxhi dhe Babush" me numër prokurimi 613-22-7225-5-1-1, iniciuar nga Komuna e Lipjanit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK), me 02.05.2023, mori:

VENDIM

1. Refuzohet si e pa bazuar, ankesa e OE "Bageri Bujar Shabani B.I. & AVAG Group" sh.p.k. seli në Ferizaj, ushtruar në OSHP me 02.03 2022, kurse vertetohet Vendimi i AK për dhënie të kontratës, i komunikuar me njoftimin e datës 23.09.2022, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i rrugëve në lagjet Sllovi, Gadime, Smallushe, Gumnaselle, Llugaxhi dhe Babush" me numër prokurimi 613-22-7225-5-1-1,
2. Konfiskohet shuma e mjeteve të deponuara në emër të tarifës ankimore, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës, konform paragrafit 5, të nenit 31 të Rregullores për punën e Bordit të OSHP.

Arsyetim

- faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 23.09.2022, Komuna e Lipjanit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK), ka publikuar Njoftimin lidhur me vendimin për dhënie të kontratës, për aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i rrugëve në lagjet Sllovi, Gadime, Smallushe, Gumnaselle, Llugaxhi dhe Babush" me numër prokurimi 613-22-7225-5-1-1.

Me 28.09.2022, OE “Bageri Bujar Shabani B.I.& AVAG Group sh.p.k” ka ushtruar kërkesë për rishqyrtimin e Vendimit të cituar si më sipër, e cila është refuzuar me Vendimin e AK të datës 30.09.2022.

Me 14.10.2022, OE “Bageri Bujar Shabani B.I.& AVAG Group” ka parashtruar ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit Publik (Protokolli 525/22), kundër Vendimit të AK për dhënie të kontratës të datës 23.09.2022, lidhur me aktivitetin e prokurimit, me numër dhe datë të përshkruar si më sipër.

Me 28.12.2022, OSHP kishte marrë Vendim (Nr. 525/22) sipas të cilit është anuluar Njoftimi për dhënie të kontratës, kurse aktiviteti i prokurimit është kthyer në Rivlerësim.

Me 16.02.2023, duke vendosur në procedurën e rivlerësimit, AK ka marrë Vendim sipas të cilit për kontratë e ka rekomanduar OE “Quality Asphalt”&”WORLD MEDIUM” nga Ferizaji.

Me 21.02.2023, OE operatori ekonomik “KOSOVA ASFALT” SH.P.K. ka ushtruar Kërkesë për rishqyrtim e cila është refuzuar me Vendimin e AK, të datës 22.02.2023.

Me 02.03.2023, kundër Vendimit të cituar si më sipër të AK, OE “KOSOVA ASFALT” SH.P.K ka parashtruar ankesë në OSHP.

- vlerësimi dhe administrimi i provave-

(a) OSHP ka konstatuar se ankesa në rastin konkret është ushtruar në pajtim me nenin 109.1 të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pas zbatimit të procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve, sikurse parashihet me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë ankuesi ka statusin e palës së interesuar sikurse përkufizohet me nenin 105, paragrafi 1, lidhur me nenin 4, paragrafi 1.26 të LPP, kurse ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar, që do të thotë se e njëjta i plotëson kushtet në kuptim të dispozitave të cituara dhe bije nën kompetencat e këtij organi në kuptim të nenit 105, të LPP, lidhur me nenin 9, të Rregullores për Punën e OSHP

(b) Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka caktuar Panelin Shqyrtues sipas nenit 111, paragrafi 5 (ii) të LPP dhe ka angazhuar ekspertin shqyrtues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 (i) të LPP, me detyrë që i njëjti ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me këtë aktivitet të prokurimit, në kuptim të nenit 113 dhe 114 të LPP lidhur me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së cituar. Lidhur me këtë, me 10.03.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- Ankesa e OE të aprovohet si e bazuar
- Njoftimi për dhënie të kontratës i datës 23.09.2022, të anulohet dhe procedura të kthehet në Ri vlerësim.

(c) Raporti i ekspertizës i përmban elementet qenësore sikurse kërkohet me nenin 113, paragrafi 3 të LPP dhe i njëjti është pranuar nga të dyja palët, konform nenit 115 të LPP lidhur me nenin 20 të Rregullores së cituar. Në këtë rast evidentohet se Ankuesi është deklaruar se pajtohet me raportin e cituar, kurse AK është deklaruar se nuk pajtohet. Po ashtu konstatohet se palët janë në dijeni lidhur me shkresat kompletet kësaj lënde sikurse kërkohet në pajtim me paragrafin 2, të nenit 20 të Rregullores për Punën e OSHP, prandaj ka kushte që Paneli të vendosi në mënyrë meritore përkitazi me ankesën e ushtruar në rastin konkret. Paneli konstatoi më tej se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, prandaj analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca publike me palë sepse ka prova të mjaftueshme për të vendosur sipas paragrafit 1, të nenit 24 të Rregullores së cituar.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave-

Duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherit duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli konstatoi paraprakisht se:

- AK ka zbatuar procedurë të hapur të tenderimit; lloji i kontratës: punë; vlerë e madhe; vlera e parashikuar e kontratës: 734, 215.00 €;
- Kurse, aneksi ka atakuar vendimin e AK për eliminimin e tij/sajë nga ky aktivitet i prokurimit, me pohimin se arsyetimi i vendimit nuk qendron dhe se AK ka vepruar në kundërshtim me Nenin 7, 59, 60 LPP dhe Nenin 26, 41, 28 të RrUOPP;

Në arsyetimin e vendimit të atakuar, shpjegohet se AK ka vepruar (në procedurën e rishqyrtimit) në harmoni me kërkesat e OSHP, sikurse janë theksuar ato në Vendimin PSH. Nr.525/22, datë 28.12.2022, për të vërtetuar faktin nëse ankuesi e plotëson apo jo kërkesën e DT, e vendosur tek Kapaciteti teknik dhe profesional: *pika r. Makine gjysmë rimorkio speciale për vendosje te bankinave për rreth rrugëve (1 cope)*. Sikurse vërtetohet nga shkresat e kësaj lënde, vërtetë AK ka kërkuar prova dhe shpjegime plotësuese, posaçërisht nga Qendra e regjistrimit të automjeteve të Komunës së Ferizajt, e cila i ka dorëzuar ato dokumente me të cilat ankuesi është paraqitur për regjistrimin e këtij mjeti, me ç'rast të njëjtat renditen dhe përshkruhet se çfarë ato përmbajnë:

- a) Fatura, në të cilën shkruan: Ky mjet nuk ka marke, tip dhe numër serik;
- b) Certifikata mbi rregullsinë e automjetit, në të cilën figuron numri: S19500GH;
- c) Dudi Doganor, në të cilën figuron numri: S 19/500-GH;

Meqë fatura e cituar përmban përshkrimin si më sipër dhe meqë numri serik i mjetit në rastin konkret nuk përputhet në Certifikatë dhe DUD, AK ka vlerësuar se ankuesi nuk i ka plotësuar kriteret e paraparë në DT duke shpjeguar në vazhdim se, cituar: “nuk kemi kërkuar asgjë me shume se sa qe kemi kërkuar ne Njoftim për kontratë dhe në Dosje të Tenderit”.

Ankuesi, e ka atakuar me ankesë vendimin e AK për dhënie të kontratës, duke pohuar se gjatë rrjedhjes së këtij aktiviteti të prokurimit AK ka vepruar në kundërshtim me nenet 7, 59 dhe 60 të LPP dhe nenet 26,29 dhe 41 të RrUOPP ngase nuk qëndron arsyetimi në vendimin e atakuar të AK, se gjoja ankuesi nuk i ka plotësuar kriteret e paraparë në DT duke shpjeguar në këtë rast se, cituar: “kemi dorëzuar librezën me regjistrim dhe kemi dhënë sqarime se kjo makinë është punim dore”. Sikurse vërehet, Ankuesi ka shpjeguar se pajisja në rastin konkret (e cila i referohet Kapacitetit teknik dhe profesional) është punim dore, kurse numri serik i cili gjendet në makine nuk është numër i standardizuar i prodhuesit, por është numër i cili ka mbetur nga pjesët e elementeve të makinave të ndryshme të dalta jashtë përdorimit, të cilat janë përdorur për punimin e kësaj makine. Nga sa mund të kuptohet nga shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se kontestues mes palëve është fakti, nëse makina e ankuesit, e cila është punim dore, i plotëson apo jo kushtet që e njëjta të konsiderohet se tillë në kuptim të pikës r, të DT (Kapaciteti teknik dhe profesional) me ç’rast AK shprehimisht ka kërkuar në DT, cituar: *Makine gjysme rimorkio speciale për vendosje të bankinave për rreth rrugëve (1 cope)*.

Në fakt, të gjitha pohimet ankimore janë përfshirë dhe analizuar edhe në raportin e ekspertit shqyrtues, i cili pretendimet e ankuesit se gjatë ri-vlerësimit të ofertave AK ka vepruar në kundërshtim me nenet 59, 60, dhe 56.3 të LPP kur ka eliminuar ofertën e ankuesit, i ka vlerësuar të bazuara ngase sipas tij/sajë, AK ka kërkuar dokumente të cilat nuk janë paraparë në DT.

Në ankesë dhe në raportin e ekspertit shqyrtues theksohet se lidhur me mjetin apo makinën e cituar si më sipër, ankuesi e ka dorëzuar (me ofertë) librezën e regjistrimit, me validitet, e cila i dedikohet pajisjes së kërkuar Makine gjysmë rimorkio speciale për vendosje të bankinave për rreth rrugëve (min 1 cope) por edhe përkundër kësaj, sipas ekspertit AK ka kërkuar nga OE që ta dorëzojë edhe faturën e blerjes, dudin doganor dhe librezën, sikurse janë prezantuar ato kontekstin e pohimeve si më sipër. Sikurse ankuesi ashtu edhe eksperti shqyrtues kanë shpjeguar se pos librezës së regjistrimit të këtij mjete, ankuesi ka bashkangjitur fotografi dhe procesverbalin nga vendi i ngjarjes të noterit LPR. Nr. 13237/22, Ref. Nr. 2704/2022 i cili konfirmon se ankuesi e posedon një makinë të tillë, punim dore është adoptuar nga makinë e emulizionit i janë marrë shumë pjesë të metalta dhe në njërin nga pjesët e marra i ka ngelur Nr. Serik i makinës së mësipërme të emulizionit e njëjta është e regjistruar me Targa 05-336- TA.

Në të tilla rrethana, Paneli konsideron se AK në këtë rast ka pasur të drejtë në krijimin e bindjes së tij të pavarur se cili nga gjithsejtë 11 ofertuesit, i plotëson kumulativisht kriteret e DT, natyrisht në mënyrë sa më të përshtatshme dhe profesionale nga aspekti i pajisjeve, meqë natyra e aktivitetit të prokurimit në rastin konkret, e detyron secilin AK që të udhëhiqet me kujdesin dhe vëmendjen e duhur në kuptim të kualifikimit të ofertuesve, në procesin e vlerësimit. Lidhur me këtë, në paragrafin 1, të nenit 59 të LPP, shprehimisht parashihet se përgjegjësia në raste të tilla i adresohet direkt AK, sepse, cituar: “Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës”. Prandaj Paneli konsideron se

në rrethana të tilla AK ka pasur të drejtë të hulumtoj, të krijoj bindjen e pavarur të tij/saj dhe të vendos se cili nga ofertat i përgjigjet më së miri planifikimit të prokurimit dhe përcaktimit të nevojave në kuptim të nenin 8 dhe 9, të LPP. Secili AK, duhet ti kushtoj vëmendjen e duhur plotësisht kriterëve, jo vetëm në kuptimin e plotësisht formalë të kushteve dhe/ose dokumentacionit, por edhe në aspektin përmbajtjesorë, sepse plotësimi i kushteve nënkupton dhe zotësinë për realizimin sa me të sigurtë të një projekti. Meqë aktiviteti i prokurimit në rastin konkret, i referohet ndërtimit të rrugëve, të cilat i përfshijnë së paku në gjashtë lagje dhe komunitete të banuara (Sillovi, Gadime, Smallushe, Gumnaselle, Llugaxhi, Babush) do të thotë se, përgjegjësia e AK nuk fillon e as nuk përfundon me procedurën e seleksionimit të ofertave në fazën e vlerësimit, por një përgjegjësi e tillë i ngel AK, sidomos në fazën e implementimit të kontratës e cila në çdo kohë, në rast të parregullsive mund të pezullohet nga ana e OSHP në kuptim të nenit 133 të LPP. Prandaj aftësia për implementimin e një detyrimi të tillë kontraktues, përbën çështje substanciale në procesin e vlerësimit të ofertave.

Prandaj bazuar shkurtimisht në të lartcekurat, Paneli konsideron se AK ka vepruar në harmoni me nenin 56.3 të LPP, duke e rekomanduar njërin nga gjithsejtë 11 konkurrentet, në kontekstin e kriterëve të paraparë në DT dhe në harmoni me natyrën e aktivitetit të prokurimit. Është e vërtetë se ankuesi ka ofertuar me çmim më të lirë në raport me OE të rekomanduar, mirëpo vërehet se oferta e OE të rekomanduar po ashtu është më e ulët se gjithsejtë dhe 7 ofertues tjerë.

Prandaj në raste të tilla, fakti nëse një OE është eliminuar nga konkurrenca dhe/ose është rekomanduar, nuk bazohet ekskluzivisht në një kriter të vetëm, sikurse vihet në fokus të vëmendjes në këtë rast, në raportin e ekspertizës, Librezja e qarkullimit. Sepse, jo një librezë e tillë, por i gjithë dokumentacioni vlerësohet në kontest integral të një oferte dhe gjithë kriteret vlerësohen në kontekstin e tyre integral, sepse zbatimi i një kontrate natyrisht se nuk bazohet në një kriter të vetëm. Së këndejmi, Paneli konsideron se AK ka vendosur dhe vepruar në mënyrë objektive dhe se në procesin e vlerësimit dhe ekzaminimit të ofertave nuk ka bërë shkelje të nenit 6, 7, 56, 59 dhe 60, pa nevojë që në këtë rast të përshkruhet secila nga dispozitat. Në të vërtetë, një seri e raporteve të shqyrtimit paraprak karakterizohen me përshkrimin e dispozitave të LPP dhe/ose Rregulloreve të ndryshme, me çrast në disa raste Paneli e ka shpjeguar se komentet dhe/ose vetëm përshkrimi autentik i tyre nuk përbën provë.

Njëherësh, OSHP rithekson se çdo AK, në çdo nivel, qendror apo lokal, gëzon pavarësi në ushtrim e kompetencave dhe caktimin e nevojave që duhen përmbushur në harmoni me kapacitet buxhetore duke e pasur të qartë se disa nevoja, në varësi të rëndësisë së tyre ekonomike, kërkojnë po ashtu bindjen e AK për plotësimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale nga OE, kurse vlera e tenderit me çmimin më të lirë, nuk e nënkupton në mënyrë absolute tenderin ekonomikisht më të dobishëm për një autoritet kontraktues, sepse sikurse theksohet në paragrafin 1, të nenit 18, sipas të cilit, “vlera e parashikuar e një kontrate të propozuar të punëve është e barabartë me çmimin e parashikuar që do të paguhet nga autoriteti kontraktues për të gjitha punët, shërbimet, produktet si dhe lëndët e tjera që mbulohen nga ajo duke përfshirë – në rast të një kontrate të punëve – lëndët e nevojshme për ekzekutimin e kontratës në fjalë që duhet ti vihen

në dispozicion kontraktuesit të punëve nga autoriteti kontraktues”. Sidoqoftë, Paneli vëren se autoriteti kontraktues në këtë rast, nuk ka hartuar specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë ndonjërin nga operatorë ekonomik në raport me të tjerët, por ka kërkuar që kërkesat ekzekutuese dhe funksionale duhet të jenë të sakta në mënyrë që të iu mundësoj tenderuesve që të përcaktojnë lëndën kryesore të kontratës dhe t’i lejoj autoritetet kontraktuese që të shpërblejnë kontratën, siç parashihet me paragrafin 8, të nenit 28, të LPP.

- Përfundim -

Në kontekstin e fakteve dhe rrethanave të cilat e karakterizojnë këtë aktivitet të prokurimit, Paneli vlerëson se nuk ka shkelje të dispozitave me karakter material dhe/ose procedural, të cilat janë përshkruar në ankesë dhe në raportin e ekspertizës dhe njëherësh nuk ka rezultuar që AK të ketë bërë shkelje të nenit 1, të këtij Ligji (Qëllimi) lidhur me nenin 6 (Ekonomiciteti dhe Efikasiteti), përderisa veprimet e AK nga pikëpamja e këtij Paneli tregojnë transparencë kurse aktiviteti i prokurimit ka rrjedhur në mënyrë efektive.

Prandaj Paneli Shqyrtues ka konstatuar se veprimet e AK janë ndërmarrë sikurse kërkohet në kuptim të nenit 56 (Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave), lidhur me nenin nenin 60 (Kriteret për Dhënien e Kontratës). Prandaj nisur nga të lartcekurat dhe duke i administruar me kujdes të gjitha provat e bashkëngjitura në shkresat e kësaj lënde, Paneli Shqyrtues ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi i bindur se ka aplikuar zgjidhjen e duhur. Në këtë rast dhe krahas tjerash, duhet shpjeguar se ndonëse raporti i ekspertit shqyrtues nuk përbën ndonjë akt me efekt detyrues për palët apo për OSHP, i njëjti e manifeston karakterin e tij provues në kontekstin e përgjithshëm të një aktiviteti të prokurimit dhe në raport me analizimin e gjithmbarshme të shkresave të një lënde. Dhe se, vlerësimi dhe vendosja meritore në procesin e shqyrtimit, është kompetencë e drejtë për drejtë e Paneli shqyrtues, i cili manifeston pavarësinë profesionale dhe institucionale në zbatim të kompetencave të parapara me LPP.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues duke u bazuar në provat e prezantuara dhe administrimin e tyre, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi konform nenit 117 të LPP.

Kryetar i panelit shqyrtues
Vedat Poterqoi



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi, nuk lejohet ankesa por pala e pakënaqur ka të drejtë që ti drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi i dorëzohet;

- AK–Komuna e Lipjanit
- OE Ankues
- Arhivës së OSHP;
- Për publikim në ueb-faqe;